

Nr rendor.	Data e Kërkesës.	Objekti i kërkesës.	Data e përgjigjes.	Përgjigje.	Mënyra e përfundimit të kërkesës.	Tarifa.
413705	10.01.2022	Fshati Shkjezë Bashkia Vau Dejës. I është dëmtuar shtëpia nga tërmeti i shtatorit 2019, dhe akti i konstatimit e ka shpallur t pabanueshme. Jetojnë në një çadër të amortizuar.	18.01.2022	Me qëllim përmbushjen e detyrimit financiar ndaj shtetasit, do të realizohet kontrolli dhe analiza e dokumentacionit tekniko-ligjor për të gjeneruar të saktë masën e kompensimit, brenda disponibilitetit financiar.	E plotë.	Nuk ka.
413503	17.01.2022	Fshati Dardhë, Bashkia Fushë-Arrëz. I është dëmtuar shtëpia nga rrëshkitjet e tokës.	18.01.2022	AKMC do të realizojë vlerësimin e dosjes, për të gjeneruar trajtimin e kompensimit financiar brenda disponibilitetit të vlerës financiare të korresponduar.	E plotë.	Nuk ka.
407087	17.01.2022	Shoqata e Familjeve të përmytura në tokat HEC Fierzë.	18.01.2022	Trajtimi i kërkesave për kompensim të tokave nuk bazohet në aktet e duhura normative për të kërkuar dhe vërtetuar dhënien e ndihmës së pretenduar dhe nuk është fushë e përgjegjësisë së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile	E plotë.	Nuk ka.
412896	18.01.2022	Z. x në rolin e përfaqësuesit të sindikatës së fermerëve të bashkuar të Myzeqesë, të cilët janë të dëmtuar nga përmytjet e datës 11.12.2021.	18.01.2022	Është kompetencë e institucioneve të qeverisjes vendore administrimi i rastit	E plotë.	Nuk ka.
406456	20.01.2022	Fshati Gjinar, Bashkia Elbasan, banesë e dëmtuar nga rrëshkitja e dherave në 2012.	28.01.2022	Dokumentacioni për ndihmen financiare nuk është i plotë dhe i sakte.	E plotë.	Nuk ka.
401217	20.01.2022	Lagje Dylli Haxhire, Bashkia Elbasan, banesa e dëmtuar nga tërmeti I dy viteve më parë.	26.01.2022	Me heqjen e zërave të pasaktë të punimit, do të jetë 50% e vlerës së llogaritur nga vlera e rishikuar e preventivit ndërtimor.	E plotë.	Nuk ka.
1	20.01.2022	Fshati Tucaj, Bashkia Bajram Curri, banesë e dëmtuar.	04.02.2022	Në mungesë të dokumentacionit, AKMC nuk mund të kryej procedurat për të vërtetuar dhe realizuar kompensim financiar.	E plotë.	Nuk ka.

418423	24.01.2022	Fshatit Bixëllë, Komuna Funar, Bashkia Elbasan. I është dëmtuar shtëpia nga erozioni i tokës në 2013 dhe jeton në çadër.	31.01.2022	Pergjegjesi e njesive te qeverisjes vendore.	E plotë.	Nuk ka.
2	04.02.2022	Gazetari kërkon informacion mbi bujqësinë.	10.02.2022	Është deleguar te ministria e Bujqësisë për kompetencë.	E Plotë.	Nuk ka.
421478	14.02.2022	Shtëpia e demtuar per shkak te termetit. Eshte shoqeruar me nje kerkese per info nga gazetare	18.02.2022	AKMC disponon dokumentat dhe do te realizohet vleresimi i dosjes.	E plotë.	Nuk ka.
3	25.02.2022	Gazetare e EuroNews kerkon informacion per masat e marra mbi konfliktin Rusi- Ukraine.	28.02.2022	Institucionet pergjegjese kane marre masat e nevojshme konform legjislacionit ne fuqi.	E plote.	Nuk ka.
4	25.02.2022	Problem me kafazin e shkallëve.	04.03.2022	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, bazuar ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, përkatësisht pikës 1, të nenit 65, “Buxheti i bashkive”, dhe nenit 41, “E drejta e kompensimit”, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në referencë edhe me rastin e përcjellë, trajtimi i situatës së pretenduar nga ana e shtetasit ngelet nën administrimin e plotë të Bashkisë, e cila mbështetet në parashikimin minimal prej 4% të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të siguruara nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Nëse bashkia nuk ka fond të mjaftueshëm për kompensim i planifikon ato për vitin pasardhës deri në masën e kompensimit të objektit të dëmtuar, dhe në rast se vlera e kompensimit tejkalon 8% të buxhetit të bashkisë, Komiteti i Mbrojtjes Civile me kërkesë të njësive të vetëqeverisjes vendore, vendos që kompensimi të kryhet nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Për sa më sipër, me qëllim shmangien dhe mënjanimin e çdo problematike të mundshme,	E Plotë.	Nuk ka.

				kërkesa për ndihmë duhet ti drejtohet Bashkisë Mat.		
421898	23.03.2022	Kerkese nga Qytetari per pagesen e ndihmes financiare per viktimat nga djegia e shtepise nga zjarri.	24.03.2022	Bazuar nenit 30, shkronja gj të Ligjit 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, efektet financiare të të cilit fillojnë në vitin 2020, rasti në fjalë nuk trajtohet bazuar VKM-së nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, por nga bashkitë të cilat kryejnë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë në territorin e tyre, vlerësimin e nevojave për përballimin e tyre, si dhe dëmshpërblejnë shtetasit për fatkeqësitë e ndodhura në territorin e tyre. Për sa më sipër, për zgjidhjen e kësaj problematike, duhet t’i drejtoheni institucioneve të qeverisjes vendore.	E plote.	Nuk ka.
432294	24.03.2022	Ankesa nga qytetarin per shtepine e vjeter te komshiut.	25.03.2022	zgjidhja e kësaj problematike, nuk është në fushën tonë të veprimit.	E plote.	Nuk ka.
5	28.03.2022	Kerkese nga Avokati i Popullit per informacion per qytetare.		Kthyer pergjigje me shkrese.	E plote.	Nuk ka.
6	28.03.2022	Kerkese per informacion pse nuk eshte perfshire qytetari ne kestin e rradhes te demshperblimit.	04.04.2022	AKMC ka kërkuar vënien në dispozicion të dokumentacionin tekniko-ligjor nga Bashkia Shkodër, për shtetasin Rruzhdhi Hoxha, dhe pas vlerësimit të dokumentacionit, bazuar akteve normative në fuqi dhe brenda mundësive të saj financiare, do të realizojë kompensimin e dëmit të shkaktuar.	E plote.	Nuk ka.